

Ismail Doda

VARIANTA E PLOTË E KËNGËS SË MYRTA THTJANIT

Kënga e Myrta Thtjanit është mjaft e vjetër dhe këndohet ç'prej kohësh në Krajë. Publiku ynë lexues dhe ai shkencor gjer më sot e kishte të njohur varianten e vjetër, të shënuar nga Ramadan Sokoli dhe të botuar për herë të parë, me sa më kujtohet mua, në botimin e Institutit të Shkencave të Tiranës: *Këngë popullore historike*, zgjedhur dhe pajisur me shënime nga Qemal Haxhihasani nën kujdesin e Zihni Sakos, Tiranë 1956, në faqen 260, me titullin: „N'pastë mbetë gjallë prap dua me e vra”.¹



Fig. 1. Panoramë nga fshati Ftjan i Krajës

¹ Shih dhe ribotimin identik në përmbledhjet: Instituti i Folklorit, *Këngë popullore historike* (1878-1912), përgatitur nga Q. Haxhihasani nën kujdesin e Z. Sakos, Tiranë 1962, në f. 106, me të njejtin titull; dhe Demush Shala, *Këngë popullore historike*, Prishtinë 1973, në f. 261, me titullin „Robt pa bukë më kanë qëllue”.

Është kjo një këngë historike me motiv shoqëror, me një poentë të theksuar të ribelimit individual kundër shfrytëzimit. Kënga fillon drejtpërdrejt me përshkrimin e vrasjes së zotërisë, Ismail Begut, në mes të Stambollit, nga ana e Myrta Thtjanit (v. 1—7) dhe në retrospektivë tregohen shkaqet që e shtynë protagonistin të bëjë këtë vrasje — sepse zotëria nuk ia kishte paguar hakun për kohën që Myrtja kishte shërbyer pranë tij, dhe, ç'është edhe me keq, ia kishte sharë prindët (v. 8—18), për t'u përmyllur me pohimin krenar të Myrtës që nuk dëshironte t'i bjerë mohit këtij akti, edhe pse një gjë e tillë mund ta shpëtonte nga dënimi. Përkundrazi, do të ishte gati ta përsëriste gjestin e tij, sikur të mësonte që beu kishte mbetur ende gjallë (v. 19—23).

Gjatë punës sime kërkimore në terrenin e Krajës pata rastin të shënoj një variante më të gjatë të kësaj kënge popullore historike, e cila, më shumë se sa variante, është në të vërtetë e njëjta këngë, por në formën e saj më të plotë, pothuaj ashtu siç do ta ketë hartuar këngëtari popullor. Ndërsa, kënga e parë, ajo që njihej gjer tani, është vetëm një formë fragmentare dhe e cunguar e këngës së vërtetë dhe të plotë të Myrta Thtjanit, të cilën po e riprodhoj këtu poshtë.

KANGA E MYRTA THTJANIT

- N'Beshiktesh² u knua fermani.³
 Në Stamollë po bâhet nami.
 Zat, ket lutht-e kush e bâni?
 Luthtë po bânte Myrta Thtjani.
 5 Në Stamollë bâhet një nám —
 luthtë po bânte nji kranjan,
 nji kranjan, nji djalë i ri,
 Myrta Thtjani me allti;
 luthtë po bân n'Jeni Xhami.⁴
 10 U mush rruga n'suhari.⁵
 Suharitë e bregut 'detit
 thanë: — U vra 'i mydyrr⁶ mejtepit.
 Nuk kish kjenë mydyrr mejtepit,
 por kish kjenë miralla⁷ i mretit.
 15 S'kish kjenë mydyrr veç kajmekam;⁸
 mreti pashë sat desht m'i bâ,
 por s'e la-o nji kranjan.
 Myrta Thtjani i kish thanë:
 — Smail Beg, pash jetën tande,
 20 pa t'bâj be hakum me m'llan-e!
 Smail Beg, hakun ta dua,

² *Beshiktesh*, lagje e Stambollit

³ *ferman-i*, dekret, urdhër me shkrim që lëshonte sulltani.

⁴ *Jeni Xhami*, Xhamia e Re që ndodhet në Stamboll.

⁵ *suhari-ja*, kalorës.

⁶ *mydyr-i* 1) udhëheqës, drejtor; 2) udhëheqës (qeveritar) i një prefekturë ose nënprefekturë në kohë të sundimit turk.

⁷ *miralla-i*, kolonel

⁸ *kajmekam-i*, 1) mëkëmbës i vezirit ose i valisë në një trevë administrative, ose në ndonjë detyrë; 2) prefekt.

- n'vilajet⁹ kam dashtë m'i çua —
 robt pa bukë më kanë qillua.
 Shum kamxhikt m'i ke kallxua;
- 25 m'ke sha robt e m'ke sha mua.
 Kur m'i shave babë e nanë,
 m'u drill toka për nan kamë.
 Haq alltinë e ja ka llanë.
 — Maj allti ti kjosh bekua
- 30 qi ma zbardhe faqen mua!
 Enver Pasha¹⁰ pa pevet:
 — Zat, Smailin ç'e ka gjetë?
 — Te xhamija â shtri me fjetë —
 e vrav bahçevani i vet.
- 35 Vajt e e thirri Hasan Pasha:¹¹
 — Ksaj pune, djalë, me i ra hasha!
 Bjeri hasha, Myrteza,
 bjeri hasha: „S'e kam via”!
- Hasha, pashë, nuk du me i ra;
 40 me kjenë gjallë prap kishe m'i vra!
 Myrta Thtjani 'i djalë i ri,
 e ka vra zatninë e tij.
 Myrtezanë në burg e çuan.
 N'burg kushrini i ka qillua;
- 45 n'burg kushrini i atij t'vramit
 fart p'i sillet Myrta Thtjanit.
 Kushrinit pa i çojnë bakshishe,
 ja çojnë thikën pshtjellë me mish-e.
 Nji ditë n'Myrtan ai u lshua.
- 50 Myrtja mirë i ka qindrue;
 zak shqyptarit ka qillua —
 ja kap dorën elle thikën,
 me thikë t'tij ja xorri shpirtin,
 me thikë t'tij e la pa krye.
- 55 Elle burgun e ka thye;
 me shokë t'tij e me shokë t'vet
 iku, shkaj në vilajet.
 Kush ja ha puntorit hakun,
 dije mirë se i ka gjakun.
- 60 Nuk hahet gjaku i shqyptarit.
 Jam kranjan e pika e djalit.

Siç shihet, varianta e sipërme, e njohur në popull me titullin *Kanga e Myrta Thtjanit*, ka 61 vargje (në krahasim me varianten e parë prej 23 vargjesh) dhe, gjithnjë, duke ruajtur stilin e vet konciz, që është karakteristikë e këngëve

⁹ *Vilajet-i*, krahinë, njësi e gjërë administrative turke, që përfshinte disa prefektura, e qeverisur nga një vali. Këtu ka kuptimin — në vilajetin tim, në vendin tim.

¹⁰ Duhet të ketë qenë prefekt i Stambollit

¹¹ Kryetar i gjyqit në Stamboll.

popullore historike, dhe, pa u shtrirë në zgjatje të tepërta narrative, plotëson me të dhëna suplementare momentet kryesore të variantes së parë dhe e pasuron atë me episode krejtësisht të reja (v.43—61). Kështu, nga kjo variante mësojmë që mydyrri, apo mirallai ose kajmekami (sipas var. II), ishte caktuar të bëhet pasha po atë ditë (v.16), dmth. ishte një fytyrë e njohur dhe e afirmuar në administratën e Stambollit. Aq më e madhe, pra, na duket ironia e shfrytëzimit në këtë rast, se si një funksionar kaq i lartë politiko-administrativ bie aq poshtë sa t'ia hajë hakun kopështarit të vet (v.34). Vargjet 31—32 vejnë në pah interesimin e Enver Pashës (që nuk përmendet në varianten I), i cili, sipas dëshmive të informatorëve Ndoc Gjergj Pëpjonaj dhe Avdullah Beqir Tyke-



Fig. 2. Pjesa e përparme dhe kulmi i shtëpisë së Myrta Thtjanit

mani (bashkëvendës dhe shokë të Myrtës qoftë në vendlindje, qoftë në mërgim) duhet të ketë qenë prefekt i Stambollit. Në vargun 37 përmendet të vetmen herë, emri i plotë i protagonistit — Myrteza, ndërsa Myrtë është forma e shkurtër dhe e përdorur në popull. Por, të dhënat më të rëndësishme në këtë variante të re janë, padyshim, dy episode që ndodhen në fund të këngës: a) përpjekjet e dështuara të kushëririt të burgosur të Smail Begut që të vrasë Myrta Thtjanin në burg (v. 44—54) dhe b) ikja e protagonistit nga burgu me shokët e vet (v. 55—57). Dhe këto dy episode e plotësojnë edhe më shumë fizionominë e heroit të kësaj kënge — të bujikut të vuajtur mergimtar, në luftë të vazhdueshme me varfërinë, me ata që e shfrytëzonin dhe e mundonin, në luftën plot vuajtje për ekzistencë dhe për të mbetur gjallë, i lirë dhe me dinjitet.

Kush ishte dhe si çmohej në popull Myrta Thjtjani?

Myrta, i biri i Can Ali Mujajt, lindi rreth vitit 1877 në fshatin Ftjan¹² të Krajës, në një familje të varfër bujqish që mbahej gjallë nga prodhimi i një toke të dobët tri katër ditë lavër qeshë. Aty, në fshatin e lindjes, Myrta e kaloi fëmijësinë deri në moshë të miturisë, me të jatin, Canin,¹³ me të ëmën Fatimen (bijë e barkut Alibriskaj nga fshati Brisk i Sipërm, e cila i vdiq rreth vitit 1890) dhe me të vëllanë më të madh, Alushin. Pas vdekjes së gruas së parë, Fatimes, Cani u martua me Ajshen, të bijën e Ali Tafës — Metaj nga Ljarja.¹⁴ Ajshja vdiq aty nga viti 1907.



Fig. 3. Pjesa e prapme e shtëpisë së Myrta Thjtjanit, që ndodhet nën një kulm me atë të kushërinjve të tij, që është e gelqerosur.

¹² Thjtjani në gjuhën zyrtare shqipe quhet Ftjan. Në sërbo-kroatisht kanë zënë ta quajnë Tejani. Fshati emrin e mori nga familja e Ftejve, shtëpisë më të parë që zuri vend këtu. Ajo kurrë nuk u shtua. Para ca kohe, kur u bënë 4 shtëpi, tri dolën në Ulqin e një mbeti aty, pohon xha Kasem Ramë Mujaj. Ftjani është fshat me tri lagje dhe 44 shtëpi, nga të cilat pothuaj çdo e dyta, edhe tani ka ndonjë mashkull në mërgim. Fshati ndodhet në mes të Anës së Sipërme (Krajës veriore, Shestanit) dhe Krajës së Madhe. Ndonëse në pikëpamje të të folurit është diçka më afër me Anën e Sipërme, përse u përket dokeve e zakoneve, pozitës territoriale dhe përkatësisë administrative, i takon Krajës së Madhe. Por të 12 shtëpitë katolike të Ftjanit, bashkë me ato të Briskut të Sipërm dhe të Briskut të Poshtëm, kanë veshmbathje dhe doke e zakone të përbashkëta me katolikët e Anës së Sipërme dhe janë besimtarë të kishës së Ljares, ashtu sikurse dhe të 7 shtëpitë muslimane të Ljares bashkë me ato të të dy Briskëve janë xhematë të xhamisë së Ftjanit.

¹³ I ati i Myrtas, Cani, vdiq pak para Luftës së Taraboshit (me këtë emër në Krajë njihet Lufta I Ballkanike) konkretisht më 1912.

¹⁴ Cani i pati me grua të dytë Fatimen, të cilës ja dha emrin e gruas së tij të parë. Më vonë Fatimja u martua në fshatin Madguesh të Krajës. Kur vdiq, la prapa Zaden dhe Sanien, që jetojnë tani në Shqipëri dhe Xhaferin, që jeton në Magdush. Alushi vdiq më 1931. Ai la mbrapa: Myrton, tani punëtor i Shtëpisë së Kulturës në Zemun, Ramazanin, tani në Tivar, dhe Nifen, të martuar për Ibrahim Beqën-Bracaj në Pinç, fshat i Anës së Sipërme të Shestanit. Të gjithë i la jashtë Ftjanit, me përjashtim të shtatë shtëpive kushërinj Mujaj, dy prej të cilave janë të dalura në Ulqin.

Varfëria e madhe që mbretëronte në atë kohë në fshatrat e Krajës, për shkak të tokës së vogël dhe të dobët që kishte çdo familje dhe për shkak të bujqësisë dhe blegtorisë primitive, kishte detyruar shumë meshkuj të këtyre fshatrave të lënë shtëpitë e tyre dhe të marrin rrugët e gyrbetit. Sidomos shkonin të punonin në Stamboll si punëtorë e rrogtarë që, me të ardhurat e tyre, të mund t'u siguronin familjeve një standard më të mirë. Edhe Myrta, që në moshë të re nja 17 vjeçare, mori rrugët e mërgimit së bashku me shumë bashkëvendas të tij. Dhe, përpos ndonjë vizite të shkurtër, nuk do të qëndrojë më për një kohë të gjatë në fshatin e vet. Më vonë tokën dhe shtëpinë do t'ia shesin nipat dhe do ta blejnë kushërinjtë, që e kanë dhe sot.

Në Stamboll hyri në shërbim te Ismail Begu, si kopështar, dhe aty punoi për një kohë të gjatë, kund nja katër vjet. Kishte një rreth miqsh shqiptarë, me të cilët shihej e rrinte herë pas here. Në mesin e tyre ndodheshin dhe disa kranjanë. Një ndër ata ishte dhe Abdullah Beqir Tykemani,¹⁵ i cili u shpreh kështu për Myrten dhe për shkaqet e grindjes me zotërinë e tij, Ismail Begun:

„Myrtja ka kjenë burrë n'shart,¹⁶ esmer, me mustakë t'trashë, i urtë e i sjellshëm me shaqni. Katër-pesë vjet punaj si bahçevan te Smail Begu n'Stamollë. Aty, ditën e Shnjergjit bâhet panair i madh. Nji vjet, n'kët ditë, desht me dalë me shetitë edhe Myrtja, por s'e la zatnija. Ai shkaj pa izen t'ti. Mirpo, kur u kthye, e hath pasha jasht. Bile e randaj me fjalë t'randa. S'desht m'i pague as hakun”.

Motivi i grindjes, sidomos i dëbimit të Myrtes vetëm për shkak të daljes në shteti pa leje ditën e Shengjergjit na u duk i potencuar, prandaj i bëmë xha Abdullahut dhe pyetje të tjera.

„Smajl Begu ish njeri i keq, kish shpirt çifuti, — u përgjegj plaku Abdullah. — Ja kish inád Myrtës se ish edhe atdhetar, ish shqiptar i mirë e mundohej m'e ngjallë gjeverinë shqiptare”.

Mund t'i marrim këto fjalë të fundit më tepër si bindje të vetë xha Abdullahut, që kishte ndejur shpesh me Myrtën dhe e njihte mirë, sesa si bindje të feudalit Ismail Beg. Në Stamboll, në vitet e fundit të shekullit të kaluar, pas Lidhjes së Prizrenit, në qarqet e emigrantëve shqiptarë, vlonin idetë liridashëse. Dhe Myrta, tanimë në moshë të përshtatshme 22 vjeçare (në kohën kur e bëri vrasjen), mund të ketë pësuar ndikimin e lëvizjes patriotike të Rilindjes, që kishte qendrën mu në Stamboll.

Por zhvillimin e grindjes, në mënyrë më të bindshme dhe artistikisht të fuqishme, na e përshkruan vetë kënga me atë gradacion, sa të natyrshëm, aq dhe dramatik e rrënoqethës, në të cilin jipen të gjitha etapat e gjendjes shpir-

¹⁵ Abdullah Beqir Tykemani, plak 94 vjeç (më 1972), i lindur në fshatin Ostrosi i Madh i Krajës. Qëndroi më se 40 vjet në gyrbet në Stamboll. Atje kaloi shumë kohë dhe me shokun, bashkëvendësin dhe moshanikun Myrta Thtjanin. Mbahet ende i fortë dhe ka kujtesë të mirë. Ndaj i kujtohet mirëfilli edhe ngjarja, të cilën na e tregoi më 20.XII.1969 dhe më 2.XII.1971. Në momentin kritik të ngjarjes qëilloi në atë lagje dhe vrapoi ku u bë vrasja, të mësojë se ç'ndodhi. Më ëndje na foli dhe për Ismail Qemalin, me të cilin ishte takuar në mërgim.

¹⁶ burrë n'short, burrë me trup të mesëm, as i gjatë shumë, as i shkurtë.



Fig. 4. Fragment nga pjesa e përparme e shtëpisë së Myrta Thtjanit

tërore të protagonistit gjatë konfliktit dhe pas tij. Myrta Thtjani nuk është tipi i vrazhdë i kriminelit kapadahi. Ai pranon me nënshtrim dëbimin nga ana e zotërisë dhe e përbeton atë vetëm që t'ia paguajë të drejtën e vet — mundin e djersës së vet:

*Smail Beg, pash jetën tande,
pa t'bâj be hakun me m'llan-e!* (v.19—20).

Por beu zemërgur është indiferent dhe ia tregon kamxhikun (v. 24). Kjo do të ishte një arsye e mjaftueshme për Myrta Thtjanin që ta dëmtonte shfrytëzuesin dhe kërcnuesin fyes.¹⁷ Por ai përsëri përpiqet ta bindë. Në të arsyeja ende mbizotëron mbi instinktin. Ende nuk është i rrëmbyer nga vendimi i vrasjes. Gjendja e mjerë e familjes në vendlindje ia imponon në formë imperative të jetë i matur. Gjithnjë duron si mali dëborën. Provon ta bindë përsëri, ta prekë në zemër beun mizor, duke i thënë se të hollat

*n'vilajet kam dashtë m'i çua —
robt pa bukë më kanë qillua.* (v.22—23)

Megjithatë Smail Begu tregohet edhe më i vrazhdë, krejtësisht primitiv — ia shan dhe robt e shtëpisë, edhe babë e nanë. Dhe e përzen.

¹⁷ Shih: *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Shkodër 1933, f. 65. — Ndera vehtjake — s. 598. Ndera e marrun nuk shpërblehet me gjã, por a me të derdhun të gjakut, a me të falun fisnikisht. . .

Ndera i mirret burrit: . . . b) Me e pshtÿ, me i u matë, me e shtÿ a me i rá kush. . .

Këtu arrin kulminacioni i dramës shpirtërore që përjeton Myrta Thtjani. Dhe këtë gradacion të tronditjes së thellë shpirtërore këngëtari popullor na e ka dhënë me një fuqi të jashtëzakonshme artistike (v.24—26). Krimi është i paevitueshëm. Sikur na duket dhe i logjikshëm. Myrta Thtjani tani harron gjendjen kritike të familjes, fatkeqësinë materiale — robt pa bukë. Atij i ka rënë një fatkeqësi e rëndë morale — i është marrë fytyra.

*Kur m'i shave babë e nanë,
m'u drill toka për nan kamë* (v. 25—26).

Dhe shoqëria do ta dënojë po të mos e lajë fytyrën. Nuk ka tjetër rrugëdalje. Dhe vendos të bëjë vrasjen.




Fig. 5. Abdullah Beqir Tykemani, lindur më 1872 në fshatin Ostros i Madh i Krajës

Abdullah Tykemani, si njeri që i njihnte disponimet shpirtërore të asaj kohe, në bazë të normave etike kanunore, e arësyetoi Myrta Thtjanin duke thënë:

„Ju desht m'i bâ njanin dysh — ose m'e çue erzin n'vend, ose me rrue me marre”.

Dhe pastaj vazhdoi të na japë disa hollësi që nuk përmenden në këngë:

„Para se me e vra, e bleu alltinë e duel me e provue n'mal. Myrtja e diti çka tash i bâjnë mrapa, por e bâni zemrën gur e e vrav pashën. Duel edhe e priti n'urë t'Bosforit. Pasha po vinte n'karrocë. Myrtja i duel para e i tha: — Pashë efendi, nalu se i kena dy fjalë unë e ti! Ai u çue me u vra me të. Myrtja ia prin, tuj ja shprazë t'gjitha n'bark”.

Kasem Ramë Mujaj, kushëri i afërt i Myrtës, dëshmon për ndonjë episod të mëvonshëm, ashtu siç ka dëgjuar nga pleqtë e kohës:

„Akhë Cani, i jati i Myrtas, e mori vesh punën se i erllën letrat n'Ftjan dorë m'dorë pej t'birin. Me një njet se p'i qesin sa ma parë pej burgut, i çoi mjaft pare. Masi ato pare s'i banë dabí, Myrtja iku pej burgut. Tuj u lshua teposhtë murit me brez leshit, i prev elle duart. Morën malin. Atje metën pa hangër.

Nji ditë pej diç duel me ble bukë n'pazar. Aty e xunë. E shtinë n'burg për njiqind e nji vjet.”



Fig. 6. Kasem Ramë Mujaj, kushëri i afërt i Myrtës, lindur në Ftjan më 1894

Edhe plaku Ndoc Gjergj Pëggjonaj,¹⁸ i cili ka jetuar për një kohë të gjatë në Stamboll, pajtohet me të dhënat e sipërme dhe shton:

„Aty ndej me da kushrij t'páshs 'vramë. Ata një ditë ju lshuen m'i mytë me thika. Me t'rame t'parë ja driptuen¹⁹ qafën e dórs anë për tjetër; me t'dytën i ranë n'krah t'djathtë; me t'tretën n'i

¹⁸ Ndoc Gjergj Pëggjonaj, plak 87 vjeç (më 1972), nga Ftjani, bashkëvendës dhe shok i Myrtas, jetoi për shumë kohë në Stamboll. Ngjarja për të cilën këndohet në këngë dhe shumë detaje të tjera rreth saj i kujtohen mirëfilli. Qëndroi në Stamboll para dhe pas kësaj ngjarje. Është ende i fortë dhe e ka kujtesën e fortë. Andaj dhe të dhënat e shkoqitjet që shënuam prej tij, qoftë më 15.XII.1969, qoftë dhe në krye të dy viteve, më 15.XII.1971, kur bëme vërtetimin dhe plotësimin e tyre, janë të njëjta.

¹⁹ driptoj, ft. depërtoj, përshkoj tej e përtej.

shmajtë. Ai u qindraj varrëve e jau kapi thikën. Me tâ njanin e mbyti e tjetrin e plagoi. Për kët gjâ e çuen n'sinop (qeli). Nisën m'e frigue me 'i rrshajë²⁰ t'malle, por s'mujtën, se u bani ballë të gjitha mundimeve”.

Sulltan Abdyl Hamiti, pas shpalljes së Kushtetutës (Hyrietit) më 23 korrik të vitit 1908, bëri ca lëshime në pushtet. Atëbotë, me rastin e një amnistie të përgjithshme që u bë për të burgosur, u lirua edhe Myrta Thtjani, pasi pat qëndruar në burg nja 10 vjet.

Përafërsisht pashën e vrau kah viti 1898. Atëherë Myrtja i ka pasur 21-22 vjet. Xha Kasemi e llogarit në këtë mënyrë:

„Kur ka ardhë mas Hyrjetit Myrtja n'Ftjan, i ka pasë 33 vjet, m'ka thanë Tahir Beqir Mujaj, atëherë plak 55 vjeç. Pra Myrtja ka kjenë 15-16 vjet ma i moçëm se unë. Me të u njoftova në pranverë të senes 1910.

U mblodhem t'gjithë e e pritëm. Zenel Osman Cena e Sylo Nezir Bogdani i knuan kangën. „Mirrni doj tjera se kyt s'isht nevoja” u tha ai me krye ulët. S'donte m'i çua kush nelt. Mirëpo gzimi s'prani dritë e dritë, gjillë natën.

Myrtja s'bani ushtri se nëj n'Stamollë. Zati n'at kohë pej dy vllazenve njani e bânte ushtrinë, kurse djelmt e vetëm ishin krejt t'liuem”.



Fig. 7. Ndoc Gjergj Peggjonaj, nga Ftjani, bashkëvendas dhe shok i Myrtës në mërgim

²⁰ rrshajë-a ef. lloj rrëshqitësi jo helmues, që arrin gjer më 9-10 m. Me musklat e veta shumë të zhvilluara e shtrengon viktinën deri sa e mbyti. Jetojnë shumë në Azin Juglindore.

Në Ftjan Myrta nuk qëndroi për një kohë të gjatë, pohojnë bashkëkohanikët e tij.

„Dy vjet para luthtës 'Taraboshit,* tahmina me 1910, Myrtas nuk deshtën m'i llanë leje m'u kthye n'Stamollë. Por kur mori vesh kapidani i Krricës²¹ se kush isht, ja lla pa fjalë,” thotë plaku Caf Cufi²².

Ndoc Gjergj Pëgjjonaj na dha edhe disa shënime të tjera për Myrtan në vitët që vazhduan:

„Si sot m'kujtohet kur erll prap Myrtja më 1911 në Stamollë. Nji vjet ma vonë shkoi vullnetarisht n'Luthtë t'Ballkanit. Shtatë muej luthtoj trimnisht n'Tarabosh m'e lirue vënin. Mas luthtet s'u kthye ma n'Krajë, veç shkoi në Stamollë. Atje u martue. Mas pak kohet u ba i lig pej veremllikut e diq pa lanë kën mrapa pej zemers tij.

I biri i áxhs, Haxhija, ja qiti dekën e e varroi në Stamollë, ku elle sot i nollet vorri”.

Kënga, e cila njihet në popull me emrin „Kanga e Myrta Thtjanit” (dhe këtë titull duhet ta mbajë), sipas pohimit të xha Kasem Ramë Mujajt, „u qit prej kranjansh qi jetoshin n'Stamollë”. Atëherë, në këngë, iu dha mbiemri



Fig. 8. Caf Cuf Duraku, lindur më 1891, në fshatin Bobosht të Krajës

* Me emrin Lufta e Taraboshit në Krajë njihet Lufta I Ballkanike.

²¹ kapidani i Krricës sërb. *Kërnjice*, fshat i Cërrnicës, afër Virpazarit, në breg të Liqenit të Shkodrës. Në Krricë ishte atëherë qendra komunale, ku gravitonin Ftjani, Ljarja dhe Shestani, pas Kongresit të Berlinit. Në atë kohë gjatë sundimit të Krajl Nikollës Miqa Lekiqi, nga Selca e Sipërme, pak përmbi Krricë, ishte kryetari i Komunës së Krricës dhe vendoste për mbledhjen e tagrave, për dhënien e pasaportave dhe për çështje të tjera administrative.

²² Caf Cufi, plak tetëdhjetë vjeç, nga fshati Bobosht i Krajës, na i dha këto shënime më 16.XII.1971. Edhe ky e njohu personalisht M. Thtjanin dhe ia arriti kohës së tij.

Thtjani, nga fshati i tij i lindjes — „çfaqje e zakonshme kjo ndër katundet tona, ndonjë njeriu që shquhet për trimni, i japin si mbiemën emnin e fshatit të lindjes ose të një vendi”.²³ Poeti anonim popullor ka qenë i informuar mirë se ka ndodhur mu në qendrën ku janë zhvilluar ngjarjet. Madje, ndonjëri nga krajanët mund të ketë vajtur ta vizitojë dhe në burg Myrta Thtjanin e të ketë marrë nga ai vetë informata e shkoqitje se si janë zhvilluar ngjarjet. Dhe këto informata pastaj janë përhapur gojë më gojë në rrethin e bashkëvendasve të protagonistit të këngës, deri në vesh të këngëtarit popullor. Prandaj, kënga është mjaft besnike sa u përket të dhënave dhe përshkrimit të episodave. Këtë na e dëshmon dhe fakti se ngjarjet dhe detajet që përmenden në këngë përkojnë krejtësisht me të dhënat e vetë informatorëve. Dhe, në këtë rast, informatorët i kemi pasur kohanikë, bashkëvendës dhe të njohur apo miq të Myrtes, të cilët poashtu kanë jetuar në Stamboll, janë shoqëruar dhe e kanë njohur mirë atë. Prandaj në të dhënat dhe informatat e tyre mund të mbështetemi kryesisht. Në Krajë këngën do ta ketë sjellur ndonjë krajan, kur është kthyer në „vilajet”.

Kënga e Myrta Thtjanit mund të radhitet ndër këngët më të bukura popullore historike që këndohen në Krajë, sidomos nga ato të sundimit osman. Ajo trajton një subjekt të rëndësishëm shoqëror — shfrytëzimin e egër individual që bëhej nga njerëzit e privilegjuar të kastës feudale-ushtarake të Perandorisë, në kurriz të njerëzve të vegjëlisë, dhe në anën tjetër, ribelimin e njeriut të thjeshtë të popullit, ribelim që gjithnjë e më tepër vinte duke marrë përmasa më të gjëra kundër këtij shfrytëzimi ekonomik, deri në luftën e organizuar për një pavarësi të plotë.

Kënga ka marrë tanimë formën e vet definitive, të skalitur dhe lapidare, pa shtesa dhe zgjatje të tepërta, e thurur me një gjuhë lakonike e me ndërtime të shkurta fjalish dhe periudhash. Dialogu konciz, i gërshëtuar aty-këtu me vargjet narrative, ia zhduk monotoninë tregimit të episodeve dhe fut gjallëri e dinamizëm në këtë hartim poetik që nuk është i varfër as nga figurat stilistike e tropet. Tetërrokshi popullor, kryesisht i saktë, dhe rimat mjaft të pasura, me përjashtime të rralla asonancash, i japin kësaj kënge një vlerë të pamohueshme artistike.

Jemi munduar ta shënojmë këtë këngë sa më besnikërisht nga Kasem Ramë Mujaj,²⁴ i cili njihet si njëri ndër këngëtarët e dalluar të Krajës dhe e këndon atë në formën më të plotë se këngëtarët e tjerë të fshatrave të Krajës që kemi dëgjuar gjatë këtyre tri-katër viteve të fundit.

²³ Anton Çetta, *Nji motërzim i plotë i këngës së Murat Gjakës*, „Jeta e Re”, Prishtinë 1955, Nr. 1-2, f. 91-97.

²⁴ Kasem Ramë Mujaj, i cili e këndoi këtë këngë më 14.XII.1969, është kushëri i afërt i Myrtes. Ka lindur në Ftjan më 1894. Bari, pastaj bujk, analfabet, dinte më se 20 këngë kreshnike dhe këngë të tjera historike, të cilat i këndonte ndenjuri dhe në valle. Ato këngë, si dhe këtë të Myrta Thtjanit i mësoi qysh në moshën e rinisë prej Zejnel Osman Cenës, vdekur më 1960 në moshën 78 vjeç si dhe prej Sylë Nezir Bogdanit, vdekur më 1969 në moshën 76 vjeç, të cilat këngë këta dy të fundit i këndonin në valle, me lahutë dhe malcorçe (me zë të lartë, pa instrument përcjellës dhe duke ia pritur njëri tjetrit).

Ismail Doda

LA VARIANTE COMPLETE DE LA CHANSON DE MYRTA THJTJANI

R é s u m é

Excepté une variante de la Chanson de Myrta Thjtjani, qu'on possède depuis 1956, l'auteur a découvert récemment encore une variante complète de cette chanson, où se complètent, d'un côté, les données de la première variante fragmentaire et d'un autre côté sont présentés encore deux épisodes, jusqu'à présent inconnus, sur le destin du protagoniste lui-même.

Myrta, cultivateur du village Thjtjan de Kraja au Monténégro, dès l'âge de 17 ans partit à Istanbul pour travailler comme serviteur, pour aider les membres de sa famille restés au village, qui vivaient dans une très grande misère. Il entra comme serviteur chez Ismail Bey, où il travailla 4-5 ans. Après une brouille avec son maître, à cause d'une sortie sans permission en ville le jour de la Saint Georges, Ismail Bey le renvoya sans le payer. Myrta Thjtjani accepta de quitter le service, mais il pria son maître de lui remettre l'argent gagné durant le temps qu'il avait servi chez lui. Il voulait envoyer cette somme d'argent à sa famille qui n'avait rien à manger. Le maître tyrannique, d'esprit féodal, non seulement ne lui paya pas son argent, mais il se précipita sur lui avec un fouet en prononçant des injures sur son père et sur sa mère. Myrta Thjtjani, rendu malheureux par la situation misérable de ses parents et spécialement vexé par ces offenses, car le bey avait profané l'honneur de sa famille, tua se bey.

Dans la nouvelle variante non éditée jusqu'à présent on parle de deux nouveaux épisodes: a) la tentation manquée des deux cousins d'Ismail Bey de tuer Myrta Thjtjan, b) l'évasion de Myrta de la prison.

C'est une chanson populaire historique avec un motif social, un trait d'esprit accentué de la rébellion individuelle contre la servitude. La composition de la chanson est traitée avec maîtrise et le contenu est présenté dans une couleur artistique séduisante, ce qui donne à la chanson une très haute qualité. C'est surtout cette gradation naturelle et en même temps dramatique qui attire l'attention, surtout par la description de l'état d'âme du protagoniste, Myrta Thjtjani, jusqu'à ce qu'il ait pris la décision de tuer son maître indigne et profanateur de l'honneur familial.

La langue concise et le style narratif très coulant mêlé de courts dialogues qui rompent la monotonie de la chanson d'une part et, d'autre part, son enrichissement par des figures stylistiques et des tropes, ont élevé cette chanson à un haut niveau artistique. Même de nos jours, bien qu'il y ait 76 ans passés depuis l'époque de ce meurtre et depuis que la chanson a été vraisemblablement composée, on chante cette chanson dans les villages de Kraja à l'occasion de différents rassemblements (fêtes, fiançailles, mariages). Elle est écoutée toujours avec un intérêt et un plaisir particuliers.

